



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**MBI PROGRAMIN KOMBËTAR TË BURSAVE PËR SHKËMBIME
AKADEMIKE NË SLOVAKI, VITI AKADEMIK 2019-2020**

Qeveria e Republikës së Sllovakisë ka shpallur “Programin Kombëtar të Bursave të Republikës së Sllovakisë (*National Scholarship Program of the Slovak Republic, NSP*)” për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të kryejnë studime, kërkime pranë universiteteve sllovaqe, institucioneve kërkimore, institucioneve të artit etj. Programi Kombëtar i Bursave mbështet mobilitetin e studentëve ndërkombëtarë, studentëve të doktoraturës, pedagogëve të universitetit, studiuesve dhe artistëve për vitin akademik 2019-2020, në programet e studimit si vijojnë:

- **Studime Master (1-2 semestra):** Të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur me një diplomë Bachelor ose të kenë kryer të paktën 3 vite studime universitare në një Universitet të akredituar jashtë Republikës së Sllovakisë.
- **Studime në Doktoratë/ Postdoktoratë/Lektorë/Kërkues/Artist (1-10 muaj):** Të gjithë të interesuarit duhet të jenë të pajisur me një diplomë bachelor dhe një diplomë master në një Universitet të akredituar jashtë Republikës së Sllovakisë.

Programi financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë dhe administrohet nga Agjencia Sllovaqe për Informacionin Akademik (*Slovak academic Information Agency, SAIA*).

Procedura e aplikimit realizohet dy herë në vit (në pranverë dhe vjeshtë). Afati i fundit i aplikimit për pranimet në pranverë 2019 është data **30 prill 2019**, ndërsa për pranimet në vjeshtë është data **31 tetor 2019**. Aplikimi realizohet online në adresën:

<https://www.scholarships.sk/en/news/academic-year-2019/2020-apply-now;>

Modalitetet lidhur me mbulimin e shpenzimeve përcaktohen pasi kandidatët të jenë pranuar nga universitetet përkatëse sllovaqe për ndjekjen e studimeve në bazë të kualifikimit që ata kanë. Gjithashtu, pala sllovaqe ofron mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit ndërkombëtar.

Përzgjedhja e kandidatëve behet nga një Komision i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë.

Kushtet për përfitimin e bursës, përshkrimin e detajuar të programeve studimore, si dhe informacione të tjera rreth programit gjenden në faqen zyrtare të internetit:

<https://www.scholarships.sk;>

<https://www.scholarships.sk/en/news/academic-year-2019/2020-apply-now;>

<https://www.scholarships.sk/en/main/programme-terms-and-conditions/foreign-applicants;>

Gjithashtu, për pyetje në lidhje me Programin e Bursave Kombëtare, kandidatët mund të kontaktojnë direkt me z. Lukáš Marcin, koordinator, në adresën:

Lukáš MARCIN,
programme administrator
Web: www.scholarships.sk, www.saia.sk
e-mail: nsp-foreign@saia.sk; tel: +421-2-5930-4733;

SAIA, n. o.
Sasinkova 10
812 20
Bratislava 1
Slovak Republic

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS